



REPubLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1029 Prot

Peshkopi, më 10/3.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr:26

Datë: 03.03.2023

“Për miratimin e shpenzimeve për investime për projektin Rikonstruksion i ambjenteve të Bibliotekës në funksion të një qendre multifunktionale ”


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Mikli



Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.341/1.prot.

Peshkopi, më 15.03.2023

Lënda : Per vendimin nr.26, datë 03.03.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER


PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.26, date 03.03.2023 “Për miratimin e shpenzimeve për investime për projektin Rikonstruksion i ambienteve të Bibliotekes në funksion të një qendre multifunksionale”, vendim i depozituar pranë nesh më datë 10.03.2023, konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në fushën e kompetencave të veta të vetëqeverisjes vendore dhe ka për qëllim legalizimin e një shtesë në buxhetin e vitit 2023 si rezultat i Kontratë Granti të nënshkruar nga Agjensia Kombetare e Rinisë në cilësinë e financuesit dhe Bashkisë Dibër në cilësinë e përfituesit.

Në këto kushte miratohet në parim një vendimmarrje e tillë në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances dhe respektimit rigoroz të detyrimeve kontraktore, veprime që kurdoherë ngarkojnë me përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturat e posaçme të Bashkisë Dibër që kanë paraqitur për miratim projekt aktin mbi bazën ka dale vendimi derguar prane nesh për verifikim ligjshmerie.

Ju tërheqim vëmendjen per mos paraqitjen e relacionit shpjegues mbi bazën e së ciles argumentohet baza ligjore dhe qëllimi i kesaj vendimmarrje, detyrim ligjor që buron veç të tjerash nga Urdheri i Ministrit të Brendshem.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 26 Datë 03/03/2023

“Për miratimin e shpenzimeve për investime për projektin Rikonstruksion i ambjenteve të Bibliotekës në funksion të një qendre multifunksionale”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxheit të vitit 2023 I konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1 prot datë 11.01.2023, kontratën nr.499 prot, të datës 09.12.2022 të Agjensisë Kombëtare të Rinisë (AKR) në cilësinë e Autoritetit të Financës dhe Bashkisë Dibër në cilësinë e Përfituesit, shkresën nr. 54 prot, të datës 07.02.2023 të Agjensisë Kombëtare të Rinisë si dhe shkresën nr.23774/140 prot, të datës 06.02.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi çeljen e fondeve për projektin e sipërcituar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.03.2023** me 18 vota pro , 1 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e investimit prej 8.500.000 (tetë milionë e pesëqind) lekë për projektin Rikonstruksion i ambjenteve të Bibliotekës në funksion të një qendre multifunksionale, çelje fondi në vlerën prej 7.650.000 (shtatë million e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë me kod investimi 22AE805.

Të shtohet:

Grupi	Kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(lekë)	Kodi i Investimit
87	01	08610	231	7.650.000	22AE805

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë **03.03.2023**.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

Adresa: | Bulevardi “Elez Isufi” Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PROJEKT- V E N D I M

Nr. 02 Datë 27/10/2023

“Për miratimin e shpenzimeve per investime per projektin Rikonstruksion i ambjenteve te Bibliotekes ne funksion te nje qendre multifunksionale”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ne vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12..2022,mbi detajimin e buxhetit te vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresen nr.19/1prot datë 11.01.2023 ,kontraten nr.499 prot te dates 09.12.2022 mes Agjencise Kombetare te Rinise(AKR) ne cilesine e Autoritetit Financues dhe Bashkise Diber ne cilesine e Perfituesit,shkresen nr.54 prot te dates 07.02.2023 te Agjencise Kombetare te Rinise si dhe shkresen nr.23774/140 prot te dates 06.02.2023 te Ministrise se Financave dhe Ekonomise mbi celjen e fondeve per projektin e sipercituar:

Kërkojmë:

I. Miratimin e investimit prej 8.500.000(tete milione e peseqinde)leke per projektin Rikonstruksion i ambjenteve te Bibliotekes ne funksion te nje qendre multifunksionale,çelje fondi ne vleren prej 7.650.000(shtate milione e gjashteqind e pesedhete mije)leke me kod investimi 22AE805 .

Te shtohet:

Grupi	kapitulli	Programi	Artikulli	Shuma(leke)	Kodi i investimit
87	01	08610	231	7.650.000	22AE805

I. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.

II. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PER BASHKINE DIBER

P/S/Finances
 Antike TORBA

Drejtori Ekonomik
 Mensur SHEHI

Kryetari i Bashkise
 Rahim SPAHIU

Ne mungese dhe ne porosi
 Ne Kryetari i Bashkise

Buzhdi DEDA



PREVENTIV

Objekti: RIKONSTUKSIONI I SALLES SE LEXIMIT TE BIBLOTEKES PESHKOPIA

Nr.	Nr.An	EMERTIMI I PUNIMEVE	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma
1		PUNIME PRISHJE				
1	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	4.5	626	2,817
2	An	Prishje suvaje	m2	155	200	31,000
3	An	Heqje dritare	cope	4	500	2,000
4	An	Heqje dere	cope	2	500	1,000
5	An	Heqje vetrare	cope	1	1,000	1,000
6	3.158/4a	Transport dheu me auto deri 4.0 km	m3	5.5	255	1,403
Shuma 1						39,220
2		PUNIME HIDROIZOLIMI TARRACE				
1	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2	110	1,232	135,520
2	2.203	Veshje kormize llamarine xingat	m2	8	1,432	11,456
3	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	cope	1	1,043	1,043
4	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml	4	693	2,772
5	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm	ml	18	822	14,796
SHUMA 2						165,587
3		PUNIME FINITURE				
1	2.108/3	Ndertim muri me knauf t=10cm me dy shtresa	m2	28	3,644	102,032
2	An	Kolle + rrjete per muret	m2	295	1200	354,000
3	2.330	Patinim allçi (stuko)	m2	295	387	114,165
4	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re akrilik	m2	295	431	127,145
5	2.276	Shtrese parketi laminat AC5 CE	m2	120	4172	500,640
6	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	17	14993	254,881
7	2.373	Vetrato xhami i temperuar alumi I zi	m2	12	15086	181,032
8	2.395/1	F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	7.8	15591	121,610
9	An	Shtrese graniti t=3cm I zi davancale dritarje ,dere,vetrate	m2	13	19500	253,500
Shuma 3						2,009,005
4		PUNIME ZJARRFIKSE				
1	An	Sistem alarmi zjarri	cope	1	125000	125,000
Shuma 4						125,000
5		PUNIME SISTEM NGROHJE				
1	An	Sistem ngrohje kaset tavanor me 4 drejtime 4x24btu	cope	1	1,200,000	1,200,000
Shuma 5						1,200,000
6		PUNIME SISTEM RRJET INTERNETI				
1	An	Instalim dhe shperdarje rrjeti internet	cope	1	55,000	55,000
2	An	Kompjutera	cope	2	75,000	150,000
Shuma 6						205,000
7		NDRICIM AMBJENTI				
1	An	Shirit led 24 wat	ml	148	1,250	185,000
2	An	Shine led	ml	30	550	16,500
3	An	Spote tub 6 wat strukture metalike	cope	25	2,200	55,000
4	An	Spote tub 8 wat strukture metalike	cope	12	2,500	30,000
Shuma 7						286,500

8.		PUNIME MOBILIMI				
1	An	1.2x0.8x0.75	cope	8	50,000	400,000
2	An	Veshje muri me melamin 1.8cm riliev	m2	75	3,800	285,000
3	An	Tavan me ristelim	m2	60	8,500	510,000
4	An	Tavan dekorativ ekzagonal melamin	cope	10	9,000	90,000
5	An	Tavoline sherbimi MDF	ml	4	55,000	220,000
6	An	Raft metalik me veshje melamin 2.5cm per libra 3x2x0.7m	m2	18	67,500	1,215,000
7	An	Vazo lulesh	cope	10	4,500	45,000
8	An	Kosh mbeturinash	cope	5	3,000	15,000
Shuma 8						2,780,000
		Shuma (1-8)				6,810,311
		Fondi rezerve	4%			272,412
		Shuma				7,082,724
		T.V.SH	20%			1,416,545
		SHUMA TOTALE				8,499,269

PREVENTIVOI
Ing.Elvis MANGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
Struktura e Integrimit dhe Ndihmës të Huaj

Nr. 2165/1 Prot

Peshkopi, më 16 . 12 . 2022

Lënda: Dërgimi i kontratave për financimin e grantit për projektin e financuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë

Drejtuar: Agjencisë Kombëtare të Rinisë

Rruga "Naim Frashëri", Nr.37 Tiranë, Shqipëri

Të nderuar,

Ju falenderoj që keni konsideruar për financim projekt propozimin e Bashkisë Dibër "Biblioteka dhe të Rinjte".


Bazuar në shkresë nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) datë 13.12.2022 për projektin e Bashkisë Dibër "Biblioteka dhe të Rinjte", bashkangjitur ju lutem gjeni 2 (dy) kopjet e kontratës të nënshkuara.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Me respekt!

KRYETARI I BASHKISË

Rahim SPAHË



Adresa: Bulevardi "Gëz Isufi", Peshkopi, Albania, Nr.tel: 00355 218 2 2935



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Agjensia Kombëtare e
Rimisi dhe mban nga dërguesi nr. 489/11 prot. _____
datë 13.12.2022 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Kontratë financimi grant për bibliotekën

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. 5767
12.12.2022 datë _____

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z _____

-Znj/Z _____

-Znj/Z _____

-Znj/Z _____

Struktura të Aditimit të Shkruar

me porosi nr. _____

Administratori praktikës sipas kësaj

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ..et) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar
do të jetë _____

Sipas afatit

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: _____


Peshkopi, më _____ 2022 _____

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË



Nr. 09/1 Prot

Tiranë, më 13 .12 2022

Lënda: Përcillen për nënshkrim kontratat për financimin me grant

BASHKISË DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Diber

I/E nderuar,


Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 566 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për Të Rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë" si dhe në vijim të takimit për nënshkrimin e kontratave për financimin e projektit tuaj fitues, Ju informojmë si më poshtë vijon:

Sipas detyrimeve të VKM-së Nr 566/2022, të sipërcituar, kontrata hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje, me fuqi të barabartë secila. Lutemi, nënshkrimin dhe vulosjen e kopjeve dhe dërgimin e 2 (dy) kopjeve pranë Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe kopjen e tretë duhet ta dispononi Ju.

Bashkëlidhur, lutem gjeni:

- 3 (tre) kopje të kontratave për financimin me grant të projektpropozimit tuaj.

Duke ju falënderuar,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

KONTRATË GRANTI

Nr. 433 Prot.

Nr. 5765 Prot.

Sot, më datë 09.12.2022, lidhet kjo kontratë midis palëve si vijon:

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), e krijuar në bazë të VKM Nr. 681, datë 02.09.2020, "Për Krijimin dhe Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë", me NIPT L42408451A, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Alqi Kushi, Drejtor i Përgjithshëm, në cilësinë e Autoritetit Financues.

Dhe

Bashkia Dibër e krijuar në bazë të Ligjit Nr. 115/2015 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", me NIPT K46908711M, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Rahim Spahiu, Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Përfituesit.

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në bazë të Ligjit Nr. 75/2019 "Për Rininë", VKM Nr.681, 02.09.2020 "Për Krijimin dhe Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë", VKM Nr. 566, datë 29.07.2022 "Për Përcaktimin e Kriteve dhe Procedurave të Përzgjedhjes së Organizatave Rinore dhe/ose Për të Rinjtë që Përfitojnë Financime nga Fondet Grant nga Buxheti i Shtetit, të Dedikuara për Rininë", Neni 659 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti i Kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është financimi me Grant, në shumën 8.500.000 (tetë milion e pesëqind mijë) lekë, me qëllim zbatimin e Projektit: "Biblioteka dhe të rinjtë".

Neni 3
Afati i Realizimit të Projektit

Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me hartimin e relacionit përfundimtar nga AKR-ja, brenda një afati 12 (dymbëdhjetë) mujor, siç parashikohet në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Formularin e projekt-propozimit të miratuar. Si moment i fillimit të zbatimit të projektit të përcaktuar në Nenin 2, do të konsiderohet dita e parë e javës së parë sipas planit të aktiviteteve dhe dukshmërisë por jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4
Shuma e Financimit të Projektit

Shuma totale për zbatimin e projektit është 9.495.000 (nëntë milion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë. AKR-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me 8.500.000 (tetë milion e pesëqind mijë) lekë. Bashkia do të bashkëfinancojë projektin me shumën që përfaqëson 10% të buxhetit total.

Neni 5
Mënyra e Financimit të Projektit (Tabela e Pagesave)

Kësti i I-rë prej 90 % të fondit grant do t'i lëvrohet përfituesit, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Kësti i II-të prej 10% të fondit grant do t'i lëvrohet përfituesit në përfundim të projektit, brenda 30 ditëve kalendarike pas miratimit të raportit përshkrues dhe financiar nga AKR.

Tabela e pagesave:

Lloji	Shuma që do të paguhet (ne Lekë)	Kushtet	Afati për pagesën
	8.500.000 (tetë milion e pesëqind mijë) lekë		
Kësti I	(90% e fondit grant të miratuar për financimin e Projektit).	Firmosja e Kontratës	45 ditë kalendarike pas nënshkrimit të Kontratës
Kësti II	(10% e fondit të miratuar për financimin e Projektit).	Miratimi i raportit përshkrues dhe financiar	30 ditë pas miratimit të raportit përshkrues dhe financiar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 6

Detyrimet dhe përgjegjësitë e përfituesit

- 6.1 Përfituesi detyrohet të respektojë të gjitha pikat e kësaj kontrate, shtojcat që i bashkëngjiten asaj si dhe legjislacionin shqiptar në fuqi;
- 6.2 Përveç rregullave të parashikuara në shtojcat e kontratës, përfituesi detyrohet:
- 6.2.1 Të kryejë aktivitetet e përshkuara në Planin e Aktiviteteve dhe Dukshmërisë;
 - 6.2.2 Të përdorë fondin grant të AKR-së sipas zërave të buxhetit të miratuar dhe vetëm për financimin e shpenzimeve për investime kapitale në infrastrukturë dhe paisje të lidhura me zbatimin e projektit;
 - 6.2.3 T'i kthejë AKR-së të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 30 ditëve kalendarike pas përfundimit të Projektit;
 - 6.2.4 T'i kthejë AKR-së të gjitha fondet e pashpenzuara pas procedurave të prokurimit publik;
 - 6.2.5 T'i kthejë AKR-së brenda 30 ditëve, pas shqyrtimit të raportit financiar përfundimtar, të gjitha fondet të cilat janë përdorur për të mbuluar shpenzimet jashtë buxhetit të miratuar të projektit apo të pa miratuara paraprakisht nga AKR-ja;
 - 6.2.6 T'i kthejë AKR-së fondet të cilat nuk justifikohen me faturat përkatëse;
 - 6.2.7 Përfituesi është subjekti përgjegjës për kryerjen me efektivitet të projektit sipas Formularit të Projekt-propozimit të miratuar;
 - 6.2.8 Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta gjatë zbatimit të projektit. AKR-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për pretendime apo kërkesë për shpërblim dëmi nga palë të treta të cilat shkaktohen nga veprime apo mosveprime të përfituesit lidhur me projektin. Detyrimet e Përfituesit sipas kësaj pike do të mbeten në fuqi pa kufizim kohor pas përfundimit apo zgjidhjes së kësaj kontrate;
 - 6.2.9 Përfituesi, nëse është rasti, duhet të dorëzojë aktin e vetëdeklarimit në formë zyrtare ku shprehet dhe deklaron se nuk lejon financimin e të njëjtit aktivitet/ iniciativë të objektit të kontratës, me shuma të financuara nga subjekte të tjera veç AKR-së dhe vetë Bashkisë, për aq sa përkon me bashkëfinancimin për këtë projekt dhe përcaktuar në Formularin e Projekt-propozimit të miratuar.

Neni 7

Raportimi

- 7.1 Për projektin që finançohet, objekt Kontrate, përfituesi duhet të dorëzojë Raportin Financiar dhe Raportin Përshkrues jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të projektit.
- ~~7.2 Së bashku me Raportin Financiar, do të dorëzohet një kopje e dokumenteve të procedurës së prokurimit të zbatuar për projektin.~~
- 7.3 Raporti Financiar duhet të plotësohet sipas formatit që do të vihet në dispozicion nga AKR-ja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Raporti nënshkruhet nga personi përgjegjës për financën në Bashki.

7.4 Raporti Përshkrues duhet të plotësohet sipas formatit që do të vihet në dispozicion nga AKR-ja, i cili duhet të shoqërohet me jo më pak se 2 (dy) kopje të publikimeve në kuadër të aktiviteteve të realizuara. Këto publikime, duke përfshirë botime, video dhe foto dorëzohen në format USB/CD. Ky raport nënshkruhet nga personi përgjegjës për projektin në Bashki.

7.5 Raportet shqyrtohen nga AKR-ja brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e dorëzimit të plotë të raporteve dhe materialeve verifikuese. AKR-ja do të ngrejë ekipin monitorues për verifikimin dhe kontrollin e zbatimit të projektit.

Neni 8

Të dhëna mbi llogarinë bankare të përfituesit:

- a) Emri i Institucionit, përfituesit: Bashkia Dibër
- b) Kodi i Institucionit: 2106001
- c) Kodi i Degës së Thesarit: 0606

Neni 9

Detyrimet dhe përgjegjësitë e Autoritetit Financues

9.1 Autoriteti financues harton kontratën tip për financimin me Grant, me qëllimin zbatimin e projektpropozimit të vlerësuar fitues në Thirrjen publike.

9.2 Autoriteti financues duhet të bëjë kalimin e kështit të I-rë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

9.2 Autoriteti financues duhet të bëjë kalimin e kështit të II-të, brenda 30 ditëve pas miratimit të raportit përshkrues e financiar përfundimtar të projektit.

9.3 Autoriteti financues harton formatin e Raportit Përshkrues dhe Financiar dhe e vendos në dispozicion të përfituesit 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

9.4 Autoriteti financues njofton përfituesin për personat përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 10
Monitorimi/Kontrolli

10.1 Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, palët duhet t'i përgjigjen kërkesës së njëra tjetrës në formë elektronike ose përmes shkresave zyrtare brenda 10 ditëve pune nga dorëzimi i saj.

10.2 Përfituesi duhet të ofrojë akses dhe raportoje në çdo kohë për personat përgjegjës për monitorim të AKR-së, pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit, për informacione dhe dokumente që lidhen me projektin dhe zbatimin e tij (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKR-ja.

10.3 Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 5 (pesë) vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo auditi dhe monitorimi nga personat përgjegjës për monitorim që përfaqësojnë AKR-në si dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, që ka kompetencë të kontrollojë shpenzimin e fondeve publike.

Neni 11
Publikimi

11.1 Përfituesi duhet të vendosë logon e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe AKR-së në të gjithë publikimet dhe materialet multimediale dhe mediatike që do të përdoren në kuadër të zbatimit të projektit, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e dukshmërisë që do të vihet në dispozicion nga AKR-ja.

11.2 Me këtë kontratë, përfituesi detyrohet të lejojë AKR-në të publikojë emrin e përfituesit, adresën, qëllimin e projektit, aktivitetet si dhe fondin e marrë, në çdo mënyrë që AKR-ja e konsideron të dobishme.

11.3 Përfituesi i Grantit, detyrohet që me shpenzimet e veta, të vendosë në një vend qartësisht të dukshëm një tabelë informuese që tregon se investimi është mbështetur nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe AKR-ja, sipas rregullave të përcaktuara në manualin e dukshmërisë që do të vihet në dispozicion nga AKR-ja. Po kështu Përfituesi duhet të promovojë edhe në rrjetet e tij sociale, webfaqe dhe dalje mediatike mbështetjen nga Autoriteti Financues për një periudhë 1 (një) vit nga afati i përfundimit të kontratës.

11.3 Pas përfundimit të projektit, përfituesi detyrohet që me shpenzimet e veta të ndërtojë 2 pllaka të përhershme me logot dhe me një mesazh të miratuar nga AKR-ja, jashtë hyrjes së objektit dhe një pllakë tjetër brenda objektit me madhësinë e konfigurimit horizontal (40 * 25) cm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 12

Pronësia e produkteve të projektit

Të gjitha produktet dhe materialet e prodhuara në kuadër të projektit mbeten pronë e Përfituesit. AKR-ja gëzon të drejtën e përdorimit të tyre sipas nevojës dhe në bashkëpunim me bashkinë përfituese, duke patur parasysh kufizimet që rrjedhin nga legjislacioni mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.

Neni 13

Ndryshimet e Kontratës

13.1 Ndryshimet e rëndësishme në mënyrën/metodën, buxhetin dhe kohën e realizimit të aktiviteteve të projektit mund të ndodhin vetëm pas një miratimi paraprak me shkrim nga AKR-ja.

13.2 Zgjatja në kohë e projektit apo përfundimi para afatit ndodh vetëm pas një kërkesë me shkrim nga Përfituesi e dërguar të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara përfundimit të projektit dhe miratimit të saj nga AKR-ja.

13.3 AKR-ja njoftohet menjëherë në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet dhe numrin e llogarisë bankare të përfituesit.

13.4 Ndryshimet në zërat buxhetorë të lidhura me investimet kapitale në infrastrukturë dhe pajisje lejohen deri në një total prej 5% të fondit të financuar nga AKR-ja dhe mund të bëhen pa miratimin paraprak të Agjencisë. Përfituesi në këtë rast duhet të njoftojë me shkrim AKR-në dhe ta pasqyrojë në raport. Ndryshimet prej më shumë se 5%, kalojnë për miratim të AKR-së.

13.5 Në rast ndryshimi të personit përgjegjës për projektin duhet të njoftohet me shkrim AKR-ja.

13.6 Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.


Neni 14

Zgjidhja e Kontratës

14.1 Kontrata mund të zgjidhet nëse:

14.1.1 Nuk realizohen aktivitetet në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate, nga Përfituesi për shkaqe të pajustificuara.

14.1.2 Kontrolli i Lartë i Shtetit ose autoritete të tjera, që me ligj kanë të drejtë kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore, konstatojnë shkelje në zbatimin dhe monitorimin e projektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

14.1.3 Ekziston Forcë Madhore.

Neni 15

Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

15.1 Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me aktivitetet në kuadër të projektit, të vërtetuara nëpërmjet Faturave Tatimore.

15.2 Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, nuk duhet të lidhen me funksionimin e përgjithshëm të institucionit dhe duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit.

15.3 Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:

- Blerje e tokës.
- Shit-blerje makinash.
- Interes mbi huadhënie
- Marrëveshje huadhënie.
- Dhurime.
- Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare.
- Veprime dhe aktivitete në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.


Neni 16

Sanksionet

16.1 Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe përshkruese, sjell paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe deri në përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

16.2 Në rastin e mospërbushjes së aktiviteteve të projektit, kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara apo kryerjes së shpenzimeve që nuk justifikohen në bazë të legjislacionit financiar në fuqi dhe udhëzimeve të AKR-së, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AKR-së dhe Përfituesi përjashtohet nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

16.3 Në rastin kur dëmtohet cilësia e aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AKR-së shumën/at e përdorur/a për financimin e këtyre aktiviteteve dhe/ose materiale publikuese.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E RINISË

Neni 17.
Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve dhe mospërbushjes së detyrimeve nga palët, për çështjet e financimit, raportimit dhe monitorimit të zbatimit të projektit objekt i kësaj kontrate, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se, brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 18
Shtojcat e Kontratës

Shtojcat e kontratës dhe pjesë përbërëse të saj janë:

1. Formulari i Projekt-Propozimit;
2. Buxheti;
3. Kalendar i Aktiviteteve dhe Dukshmërisë.


Neni 19
Të ndryshme

Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të dyja palët. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore, nga të cilat 2 (dy) i mban AKR-ja dhe 1 (një) Përfituesi. Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga :

Për AKR-në
DREJTORI PËRGJITHSHËM


Z. Alqiushi



Për Përfituesin:

KRYETAR I BASHKISË

Z. Abim Spahiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga P.A. D. H. P. V. dhe mban nga dërguesi nr. 3411 prot. datë 15.03.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot. 1029/1 datë 16.03.2023.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z Adhokosist të Famillet Peshkop

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosi të:

Administratori bashkisë Peshkop
Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë dy ditë

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 16.03.2023

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]